



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 30
Prishtinë, më 23 nëntor 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

P R O C E S V E R B A L
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Bali Muharremaj dhe Afrim Hoti.

Munguan: Murselj Haljilji, Albert Kinolli dhe Adem Grabovci

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm, Nenad Rashiq, ministër MPMS dhe Bajram Rexhepi, ministër MPB.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) – Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 04.11.2011,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës të Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010,
5. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në rend dite të përfshihet edhe shqyrtimi i propozimit të BQK-së lidhur me aprovimin e auditorit të jashtëm për periudhën 2011-2013, dhe shqyrtimi i kërkesës së ZAP-it për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës me propozimin e kryetarit të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 04.11.2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 04.11.2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, për shkak të mospjesëmarrjes në mbledhje të ministrit të MPMS, z.Nenad Rashiq, njëzëri nxori këtë

Konkluzion

Shqyrtimi i raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Social për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

4. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës të Kosovës për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2010

Kryetari - Janë dhënë 9 rekomandime prej te cilave 1 është adresuar, 4 janë ne proces (që për Komisionin janë te pa-adresuara) dhe 3 rekomandime nuk janë adresuar fare. 67% e buxhetit është shpenzuar ne tremujorin e fundit. Pse ka ndodhur kjo?

Sa i përket cilësisë së informatave sipas raportit, të dhënat janë çorientuese dhe jo te besueshme. Nuk ka përputhje në mes të librave të Ministrisë dhe të Thesarit. PVF nuk janë te plota dhe nuk janë hartuar konform kërkesave te Udhëzimit Administrativ 16/2010.

Prokurimi: është përcjellë me parregullsi te shumta. Duke filluar me kontraktimet me operator te pa-përgjegjshëm deri te hyrja në kontrata prokurimi pa kurrfarë procedurash. Vonesat ne përfundimin e projekteve kapitale dhe mungesa e monitorimit te projekteve, si dhe vonesat ne pranimin e mallrave, janë mangësi të procesit.

Ministria ka anuluar tenderin për te cilin OSHP-ja ka konstatuara se ky anulim është bere ne mënyre te kundërligjshme. Kontrata është nënshkruar me 60 dite vonesë. Punimet nuk kane përfunduar sipas planit dinamik dhe mallrat janë pranuar me vonesë, pastaj nuk ka pasur monitorim dhe mbikëqyrje te rregullt gjate fazës se ndërtimit te objekteve.

Te "Furnizimi me arme" pranimi i mallit është bere 42 dite para se te behet porosia. Pastaj, të hyrat vetanake nuk janë përdorur sipas memorandumit. Nga të hyrat vetanake janë mbuluar shujta dhe paga. Punëtoret me koeficient te njëjtë paguhën me paga te ndryshme, pastaj janë paguar paga të pabazuara pas shkëputjes së marrëdhënies së punës. Kjo i shkakton dëme të paarsyeshme buxhetit. Regjistrimi i pasurisë: nuk dihet pasuria me te cilën disponon kjo Ministri. Ministria nuk ka rregullore dhe politika programore rreth menaxhimit te subvencioneve. Ne bazë të çfarë kriterëve është bërë kjo ndarje?

Kontrolli i brendshëm - sipas konkluzionit te përgjithshëm te ZAP-it, dështime janë vërejtur ne te gjitha nivelet dhe ne te gjitha fushat e kontrollit.

Pasuritë dhe borxhet - Ministria nuk ka respektuar udhëzimin mbi regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive qeveritare. MPB nuk ka regjistruar ne SIMFK gati 1.8milion euro pasuri dhe kjo paraqet mangësi te kontrolleve te brendshme dhe reflekton ne menaxhim te dobët me pasuritë.

Bajram Rexhepi, ministër MPB – Tha se janë të përkushtuar që sa më pak të ketë defekte në prokurim dhe keqmenaxhim të parasë publike. Shumë probleme të ngritura nga ZAP-i, janë probleme të trashëguara dhe shumica e problemeve i takojnë agjensionit të policisë e cila ka pasur një pavarësi shumë të madhe të menaxhimit të buxhetit, prokurimit. MPB ka forcuar menaxhimin e financave dhe prokurimin me njerëz profesional dhe kompetent për këtë gjë. Për disa të gjetura nevojitet kohe për përmbushje si p.sh evidentimi i aseteve. Kjo është problematikë për të gjitha institucionet. Ministria me PV ka kërkuar që të bëhet regjistrimi i pasurisë, asetet do t'i regjistroj një agjension ndërkombëtar, meqenëse duhet të sigurohet pavarësi në atë drejtim. Problem tjetër ka qenë edhe mosdefinimi i pronësisë - disa objekte që kanë qenë pronë e MPB kanë kaluar në kuadër të AKP-së e më vonë në pronësi komunale, por kjo është duke u rregulluar me ligj. Pra, MPB ka marrë për obligim evuidentimin e të gjitha aseteve, ndërsa vlerën e tyre do ta bëjë një agjension i pavarur.

Barazimet e mjeteve- këto vonesa kanë të bëjnë me MPJ, të cilët nuk kanë staf të mjaftueshëm. Prokurimi – është pikë e dobët. MPB ka avancuar prokurimin e sidomos ne ministri, ndërsa në polici priten ndryshime, sepse ka defekte të mëdha si për korrupsion. Vonesat me kontraktor-rasti i Gjilanit lënda është në Gjykatë, sepse prokurimi ka qenë që në fillim i gabuar. Dhe vërejtjet në Zveqan janë duke u hetuar.

Përdorimi i të hyrave vetanake për paga dhe shujta - kjo ka ndodhur në polici e jo në ministri. Kjo nuk do të përsëritet.

Subvencione- nuk ka për ministrinë, por kanë qenë vetëm për policinë. Marrë zotimin se të gjitha vërejtjet do të inkorporohen në PV dhe do të adresohen me kohë dhe sipas ligjit.

Ilhami Gashi-sekretar MPB – Tha se janë përcaktuar detyrat për eliminimin e të gjeturave me personat përgjegjës. Pasqyrat financiare janë alarmante, por në esencë është teknike. MPB krijon edhe të hyra vetanake nga shërbimet që ofron për qytetarët. Mbyllja e librave deri sa të përpunohen të dhënat nga konsullatat krijon probleme në vonesë.

Ka probleme me përcaktimin e vlerës së aseteve dhe mënyra e vlerësimit të tyre. Ka propozuar që regjistrimi të bëhet, çmimi të mbetet i hapur derisa të merret një konfirmim qoftë nga Agjensioni i kadastrit apo nga MPH. Pastaj, implementimi i Ligjit mbi inventarin – vlefshmëria e pasurisë së luajtshme është 5,6,7 vjet dhe me qëllim që mos të ngarkohet buxheti, siç është rasti me automjetet nga UNMIK-u, të cilat ende janë në evidencë, se janë funksionale. Këto janë probleme që duhet zgjidhur bashkërisht me institucione ligjore.

Prokurimi – ka probleme në mënyrën e planifikimit, përcaktimin e kriterëve teknike dhe përcaktimin e fituesit. kriteri çmimi më i lirë po paraqet problem, sepse operatori është joserioz. Problemi më i madh paraqitet te menaxhimi i kontratës dhe auditori ka të drejtë kur konstaton se nuk shfrytëzohet momenti i penaltive. Përgjegjësit do të identifikohen me përgjegjësi dhe çdo mos përmbushje do të përcillet me procedura disiplinore dhe procedura të tjera të përcaktuara me ligj.

Ramiz Lladrovci – Inkurajoj ministrin për punën e mirë, realizimin e buxhetit për rreth 96%. Shpenzimi i buxhetit në tremujorin e fundit nuk është i jashtëligjshëm, por ekziston një rrezik i keq menaxhimit apo keq shpenzimit të parasë publike. Kjo ndodh në Kosovë për arsye se punët kryhen gjate verës dhe pagesat kryhen në tre mujorin e fundit. Inkurajoj ministrin për masat që duhet ndërmarrë për komunikimin e zyrtarëve te policisë me Ministrinë. Policia duhet të ketë pavarësinë por edhe përgjegjësinë e tyre. Dhe para këtij Komisioni është dashur të prezantojnë edhe përfaqësuesit e policisë.

Afrim Hoti – Ka të hyra vetanake në MPB nga pasaportat dhe dokumentet dhe në raport shihet

se në vitin 2010 këto të hyra janë në rënie. Pse ka ndodhur kjo? Mosbarazimi me thesarin - diferenca është prej 90 mijë euro. Pse ka ndodhur kjo?

Valbona Dibra- Dua të besojmë që të gjeturat e ZAP-it flasin për gabime teknike, sepse sikur diferencat e paraqitura në raport të ishin keqpërdorime, atëherë situata do të ishte alarmante. Sugjeroi ministrin që të marrin për bazë rekomandimin katër të ZAP-it, që të ridizajnoi një udhëzim të ri, të trajnoj stafin e prokurimit, të financave dhe të buxhetit, sepse sikur stafi të ishte profesional, gjendja në këtë ministri do të ishte tjetër.

Armend Zemaj – Për të pasur sukses duhet preventivë dhe ministri ka për tu marr me pasojat e vitit 2010. Të gjeturat e ZAP-it nuk duan koment. Urdhërblerja për furnizim me arme është bërë pasi që është bërë pranimi i mallit. Blerjet tjera shërbime të telefonisë mobile pa asnjë procedurë dhe pa aprovim të APP-së. Shefat që kanë udhëhequr prokurimin në PK, kanë pozita të larta dhe në këto raste nëse prokuroria do të ishte e pavarur, nuk ka koment në këto raste. Mbi çfarë bazë janë shfrytëzuar parat nga të hyrat vetanake, për paga dhe shujta? Pyetje për ZAP-in: a janë përputhur të gjeturat e auditorit të brendshëm me të gjeturat e ZAP-it? 12 vite investime për trajnime e magjistratura dhe prapë nuk ka ngritje të resurseve humane. Kjo nuk do koment. Kërkoj nga ministri që të ndërmarrë veprime konkrete.

Bajram Rexhepi – Shpenzimet bëhen në tre mujorin e fundit, mirëpo dëgjimet buxhetore dhe planifikimet tani janë bërë me një dinamikë tjetër dhe kjo nuk do të ndodhë më që shpenzimi i buxhetit të bëhet në tre mujorin e fundit. Agjensionet kanë vijë buxhetore dhe nuk kanë dhënë llogari në nivel të ministrisë, por tani kjo ka ndryshuar dhe policia tani gëzonë pavarësi, por japin llogari dhe koordinim me ministrinë e cila pastaj përgjigjet para Qeverisë dhe Kuvendit. Blerja për armë - më parë është bërë blerja në bazë të Rregullores së UNMIK-ut dhe kjo është bërë drejtpërdrejtë nga ZKM. Tani me ligj kjo parashihet që MPB bënë një listë nacionale për furnizim me armë e cila pastaj dërgohet në ZKM dhe lejon abrogimin e nenit përkatës të LPP. Kjo çështje është në hetuesi dhe duhet pritur rezultatet. Dy zyrtar janë suspenduar dhe zyrtari tjetër është degraduar në bazë të preferencës së inspektoratit policor. Marrëveshja me telefoni mobile-janë bërë memorandume që me çmime minimale policia të ketë mundësi komunikimi. Problemi ka qenë i pagesës që MF mjetet që shpenzohen nga rrethi policor të ndalen nga buxheti brendshëm. Kjo nuk është lejuar. Pagesat për shujta dhe paga-kjo pak është toleruar në kohë kur pagat ishin shumë të ulëta, mirëpo tani të gjitha këto kanë rënë me ngritje pagash.

Ilhami Gashi – Mosbarazimi është pasoj e vonësës së raporteve nga konsullatat jashtë. Kjo si pasojë e mungesës së stafit dhe kjo është çështje e gabimeve teknike.

Kryetari – Propozoi që Raporti të procedohet në Kuvend dhe të kërkohet një auditim i performancës në këtë ministri. Sepse, ministria do të duhej të ketë një pamje tjetër dhe në bazë të të dhënave edhe në viti në ardhshëm kjo ministri do të ketë opinion të kundërt. Domethënë tabelat nuk kanë besueshmëri, nuk kanë regjistrimin e pasurisë dhe prokurimi ka mangësi serioze.

Valbona Dibra – Tha se në këtë moment është i panevojshëm të bëhet auditimi i performancës. Masat që ka ndërmarrë ministria duan kohë për rezultat dhe normalisht që vitin e ardhshëm opinionin do të jete jo i kundërt, por me theksim të çështjes. Propozoi që Komisioni të kërkoj nga Ministria PV-në dhe një raport me shkrim për masat e ndërmarra për ristrukturim të stafit dhe masat e tjera si dhe ZAP –i të analizoj se si është gjendja atje.

Ramiz Lladrovci- Insistoi në propozimin për auditimin e performancës që duhet t'i bëhet MPB, sepse është fjala për një staf prej 10 mijë punëtorëve. Policia është për të respektuar

ligjin dhe çdo ditë jemi dëshmitarë që pikërisht policia është ajo që po shkel ligjin. Andaj, nëse ZAP ka kapacitete të mjaftueshme, atëherë duhet të bëhet auditimi i performancës.

Armend Zemaj – Raporti nuk duhet të procedohet në mbledhje plenare, pasi që raporti vjetor i auditimit është miratuar nga Kuvendi. Propozoi që Komisioni të ketë rekomandime direkt për MPB, për përmbushje me një afat kohor, sepse efekti i shqyrtimit në këtë kohe në mbledhje plenare do të ketë efekt zero.

Kryetari – Propozoi që Komisioni të kërkojë nga ZAP-i që të kërkojë nga MPB një raport të detajuar për Komisionin. Menaxhmenti përgjegjës ose nuk i njeh punët ose nuk ka një koordinim dhe qëllimi është për t'i ndihmuar ata që së bashku me auditorin të përgatisin raport për Kuvendin. Pra, ZAP të përcjell kërkesën e Komisionit.

Valbona Dibra – Tha se Komisioni duhet direkt të kërkojë raport nga MPB. ZAP-i mund t'i ndihmojë, por kërkesa për raport duhet të dalë nga Komisioni për MPB, e jo nga ZAP-i për MPB. ZAP nuk është për të bërë raporte për përgjigje, por për të parë nëse puna është kryer në rregull.

Lars Lage OLOFSSON – Këto janë probleme që hasen në shumë institucione kur ka më shumë ose me pak agjensione të pavarura dhe departamente të mëdha. Ndërkohë që ministri mbetet përgjegjës për të gjitha. Është i kënaqur me sinjalet që dha ministri dhe ZAP-i do t'i përcjell këto me auditimin e radhës. Ministria ka dorëzuar PV në ZAP. Dhe këtë çështje ZAP-i do ta përcjell gjatë auditimit të rregullsisë.

Ministri kërkojë përkrahje nga Qeveria për vlerësimin e pasurive dhe kjo është shumë e nevojshme. Pastaj, nevoja për të pasur udhëzime për mënyrën se si të kryhen punët e prokurimit. KRPP kanë premtuar që do të shpërndanin një numër udhëzimesh të gjitha organizatat deri në janar të vitit 2012.

Deri më 15 dhjetor ZAP-i përgatitë për shpenzuesit buxhetor memon, ku jepen këshillat se si dhe çka duhet ndryshuar gjërat në mes pasqyrave nëntëmuajore financiare dhe në ato vjetore financiare këshilla se si duhet menaxhuar pasqyrat financiare, masat apo mënyrat se si i kanë adresuar rekomandimet. Komisioni mund t'i kërkojë këto memo për cilëndo ministri. Auditimi i rregullsisë është i mjaftueshëm për këtë ministri.

Armend Zemaj – Tha se Komisioni duhet të dali me dy rekomandime: për MPB që brenda afatit prej tri javësh të dorëzojë raport me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me të gjeturat e ZAP-it dhe për ZAP-in që brenda tri javësh Komisionit t'i dorëzojë memon për MPB.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që MPB dhe ZAP-it t'i paraqes

KËRKESË

1. *Ministria e Punëve të Brendshme, brenda afatit prej tri javësh, të dorëzojë raport me shkrim për veprimet e ndërmarra për të gjeturat e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.*
2. *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, brenda afatit prej tri javësh t'i dorëzojë Komisionit memon e dorëzuar në këtë ministri.*

5. Shqyrtimi i propozimit të BQK-së lidhur me aprovimin e auditorit të jashtëm për periudhën 2011-2013

Kryetari – Sipas Ligjit për BQK, BQK ka kryer procedurat dhe nevojitet aprovimi ose jo i

Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Ramiz Lladrovci – Materiali është proceduar me vonesë, domethënë është i datës 22 nëntor 2011, një ditë para mbledhjes së Komisionit. Propozoi që ky material të shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit, pa u lëshuar pastaj se pa dokumente mbi bazën e të cilit është bërë përzgjedhja e auditorit të jashtëm, nuk mund të jepet aprovimi. Po ashtu materiali ka gabime teknike në shifra, si p.sh. totali i pikëve 99.94 për Grand Thornton, pastaj më poshtë tabelës thuhet 39.94 pikë.

Valbona Dibra – BQK sipas raportit ka bërë përzgjedhjen e auditorit dhe roli i Komisionit në këtë rast është vetëm formal, pa pasur dokumentacione shtesë mbi bazën e të cilit është bërë përzgjedhja.

Armend Zemaj – Ligji për Bankën Qendrore përcakton se BQK përzgjedhë auditorin e jashtëm dhe i dërgon për aprovim Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Po ashtu i njëjti ligj përcakton se në rast se BQK-ja vendos për të përjashtuar këtë auditor të jashtëm edhe këtë mund ta bëjë vetëm me miratimin e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Nëse ka shkelje ligjore është OSHP, institucion ku palët mund të ankohen.

Kryetari – Ka pasur një takim me përfaqësues të BQK-së dhe deri më tani kjo është proceduar përmes KBF. Bordi i BQK-së ka mbledhje dhe nuk do të ishte mirë të prolongohet miratimi.

Bali Muharremaj – Tha se përderisa materiali në Kuvend është proceduar me vonesë, atëherë duhet të abstenoj nga votimi.

*Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike me **tre vota për, dy kundër** dhe **një abstenim** nxori këtë*

Konkluzion

Shqyrtimi i propozimit të BQK-së për aprovimin e auditorit të jashtëm, shtyhet për mbledhjen e radhës të Komisionit.

5. Shqyrtimi i kërkesës së ZAP-it për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që kryesisë së Kuvendit t'i parqes këtë

Rekomandim

- 1. Te autorizohet KMFP që në bashkërendim me Administratën e Kuvendit përkatësisht Divizionin e Prokurimit, të bëjë përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011.**
- 2. Vlerësimin e ofertave e bënë Komisioni Vlerësues i përbërë nga anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.**
- 3. Pas përfundimit të Procedurave Komisioni për mbikëqyrjen e Financave Publike njofton Kryesinë e Kuvendit për përzgjedhjen e Auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011.**

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Autorizohet Kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike që të formoj Komisionin vlerësues për përzgjedhjen e auditorit të jashtëm për auditimin e pasqyrave financiare të ZAP-it për vitin 2011.

Komisioni vlerësues përbëhet nga anëtarët e Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe duhet të jetë tek.

3. Të ndryshme

a). Rregullat e brendshme të procedurës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

Formohet grupi punues i cili do të merret me shqyrtimin e draft rregullave të procedurës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në këtë përbërje: Armend Zemaj – kryesues, Valbona Dibra- anëtare dhe Afrim Hoti- anëtar.

b). Raporti kthyes i institucionit të avokatit të Popullit

Kryetari njoftoi anëtarët e Komisionit se IAP ka proceduar raportin kthyes në bazë të rekomandimit të Komisionit dhe vendimit të Kuvendit. Raporti do të propozohet për shqyrtim në mbledhjen e radhës të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu